



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 4802/1 Prot. Datë 26.7.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 13867/1 Prot. Datë 11.8.2023

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 16, datë 26.7.2023

PËR
ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË
MATURËS SHTETËRORE 2023 DHE MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2023

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 51 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJMË:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2023, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|-----------------------------|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 21 gusht 2023 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 25 gusht 2023 |
| c) Matematikë | 30 gusht 2023 |
| ç) Provimi me zgjedhje | 4 shtator 2023 |

2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|--|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 21 gusht 2023 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 25 gusht 2023 |
| c) Matematikë | 30 gusht 2023 |
| d) Provimi i teorisë profesionale të integruar | 4 shtator 2023 |

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2023 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.
4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë:
 - a) Fillojnë në orën 10:00;
 - b) Zgjasin 2 orë e 30 minuta;
 - c) Testet hartohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, marrin pjesë:
 - a) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2023 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i parë.
 - b) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2022-2023 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 11 gusht 2023.
 - c) Maturantët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2023, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale në vitin 2023, sesioni i parë.
 - ç) Maturantët/kandidatët që kanë kryer njohjen dhe njësimin e diplomës së arsimit të mesëm të lartë dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023.
6. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi të regjistrohesh në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën që u cakton zyra vendore e arsimit parauniversitar (ZVAP).
7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi, të plotësojnë Formularin AIZ, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë.
8. Maturantët/kandidatët me aftësi të kufizuara do të zhvillojnë provimet e Maturës Shtetërore bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 49 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
9. Bazuar në memorandumun e bashkëpunimit/mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet MAS dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Italisë, për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane”:
 - a) Përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe do të dorëzohet në QSHA;
 - b) Zhvillohet me gojë, në shkollë në datën 18.08.2023;
 - c) Zhvillohet me shkrim në mjedisin e provimit të maturës shtetërore, në datën 21.08.2023;
 - d) Rezultati i provimit gjuhë e huaj (D3), llogaritet sipas përcaktimeve të memorandumit të bashkëpunimit/mirëkuptimit, të përmendur në këtë pikë.

10. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar të dërgojë zyrtarisht në ZVAP, listën e maturantëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, deri më datë 15 gusht 2023. Drejtori i ZVAP, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 15 gusht 2023.
11. Provimet të zhvillohen të përqendruara. Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) përcakton qendrat e provimeve duke u bazuar në numrin e maturantëve dhe në largësinë nga qendra e provimit.
12. ZVAP-et dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare, të marrin masa për njoftimin e maturantëve për datat, qendrën dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë.
13. Drejtori i DPAP, brenda datës 14 gusht 2023, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe MAS, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2023, sesioni i dytë dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2023 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë.
14. Monitorimi i procesit të Maturës Shtetërore 2023 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MAS-it dhe të institucioneve të varësisë.
15. Shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2023 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2023, sesioni i dytë, të mbulohen nga institucionet ku janë të punësuar.
16. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtorja e Politikave të Punësimit dhe Aftësisë Profesional, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR
EVIS KUSHI



MINISTËR
DELINA IBRAHIMAJ

